

# Rreth demencës

FLETË INFORMACIONI NGA QENDRA SUEDEZE E DEMENCËS

Demenssjukdomar • faktablad på albanska

## Llojet e ndryshme të demencës

Demenca, e njohur edhe si çrregullim kognitiv, e bën më të vështirë të menduarit, planifikimin dhe komunikimin. Kjo për shkak të llojeve të ndryshme të dëmtimeve në tru. Simptomat shpesh shtohen gradualisht dhe e bëjnë gjithnjë e më të vështirë përballimin e aktiviteteve të përditshme pa ndihmë.

## Nuk është pjesë e natyrshme e plakjes

Simptomat e demencës janë konsideruar prej kohësh si pasojë e pashmangshme e pleqërisë. Sot dihet se rreth 100 gjendje të ndryshme shëndetësore mund të shkaktojnë demencë. Nuk është pjesë e plakjes së natyrshme, por është dukshëm më e zakonshme në pleqëri. Nga pothuajse 150.000 njerëz me demencë në Suedi, shumica dërrmuese janë më të vjetër se 75 vjeç.

## Llojet e demencës

Sëmundja e Alzheimerit është lloji më i zakonshëm i demencës dhe përbën 60-70% të të gjitha rasteve. Lloji i dytë më i zakonshëm është demenca vaskulare, e njohur edhe si çrregullim neurokognitiv vaskular. Shpesh ndodh së bashku me sëmundjen e Alzheimerit, e cila zakonisht quhet demencë e përzier.

Lloje të tjera të demencës janë demenca me trupa Lewy, demenca frontotemporale dhe demenca e sëmundjes së Parkinsonit. Abuzimi me alkoolin dhe tumoret në tru mund të shkaktojnë gjithashtu simptoma të demencës.

## Shpesh fillon me harresë

Shenjat e para të demencës shpesh janë harresa dhe vështirësi të mëdha për t'u gjetur rrugën jashtë lagjes. Veprimet që më parë kryheshin pa vështirësi, bëhen të vështira për t'u planifikuar dhe zbatuar. Të folurit ndikohet, duke u shfaqur vështirësi gjithnjë në rritje për të gjetur fjalët e duhura.


Irritimi, depresioni dhe ndryshimet e personalitetit mund të jenë gjithashtu pjesë e sëmundjes. Simptomat ndryshojnë në varësi të llojit të demencës dhe dëmtimit.

## Nga demenca e lehtë në të rëndë

Demenca shpesh ka një ecuri të zgjatur, që shtrihet në shumë vite. Sëmundja zhvillohet gradualisht, ndërsa shfaqen simptoma të reja dhe humbasin aftësitë.

Me kalimin e kohës, pacienti ka nevojë për gjithnjë e më shumë ndihmë dhe mbështetje për të përballuar jetën e përditshme.

Përparimi i sëmundjes zakonisht ndahet në tre faza: demencë e lehtë, e mesme dhe e rëndë.



## Diagnoza e hershme është vendimtare

Nëse dyshoni për demencë, medoemos këshillohuni me mjekun. Hetimi duhet të nisë pa vonesë, që të merret sa më shpejt diagnoza e saktë, ndihma dhe trajtimi. Hetimi përfshin një sërë testesh dhe ekzaminimesh të ndryshme.

Ekzistojnë disa gjendje shëndetësore që mund të shkaktojnë simptoma të ngjashme me demencën dhe që mund të shërohen. Nëse diagnostikohet demenca, ilaçet mund të lehtësojnë simptomat në disa raste. Mjetet ndihmëse, si dhe ndërhyrje të tjera të shumta, mund të lehtësojnë përballimin e jetës së përditshme.

## Planifikimi i së ardhmes

Si personi i prekur, ashtu edhe të afërmit e tij, është mirë të marrin një shpjegim për simptomat. Njohuritë rreth sëmundjes e bëjnë më të lehtë planifikimin për një jetë të mirë dhe kuptimplotë. Shpesh ia vlen të shkëmbehen përvojat me njerëz që janë në të njëjtën situatë.

© Svenskt Demenscentrum

Informacion shtesë dhe materiale informuese në gjuhën shqipe, mund të gjenden në faqen zyrtare të Svenskt Demenscentrum: [www.demenscentrum.se/al](http://www.demenscentrum.se/al)



Svenskt Demenscentrum

Svenskt Demenscentrum, Sveavägen 155, 113 46 Stockholm, (08) 690 58 00, [info@demenscentrum.se](mailto:info@demenscentrum.se)

[www.demenscentrum.se](http://www.demenscentrum.se)

# Demenssjukdomar

FAKTABLAD FRÅN SVENSKT DEMENSCENTRUM

## Flera olika demenssjukdomar

Demenssjukdomar, eller kognitiva sjukdomar som de också kallas, gör det svårare att tänka, planera och kommunicera. Det beror på olika typer av skador i hjärnan. Symtomen kommer ofta smygande och gör det allt svårare att klara sina vardagliga aktiviteter utan hjälp.

## Inget naturligt åldrande

Demenssymtom betraktades länge som en oundviklig följd av ålderdomen. Numera vet vi att närmare 100 olika sjukdomstillstånd kan leda till demens. Det är inget naturligt åldrande, däremot är det betydligt vanligare i hög ålder. Av de närmare 150 000 personer som har en demenssjukdom i Sverige är de allra flesta äldre än 75 år.

## Exempel på demenssjukdomar

Alzheimers sjukdom är den vanligaste demenssjukdomen och står för 60–70 procent av samtliga fall. Näst vanligast är vaskulär demens, även kallad blodkärlsdemens. Den förekommer ofta samtidigt med Alzheimers sjukdom, då brukar man tala om blanddemens.

Andra demenssjukdomar är Lewykroppsdemens, frontotemporal demens och Parkinsons sjukdom med demens. Även alkoholmissbruk och hjärntumörer kan ge demenssymtom.

## Börjar ofta med glömska


Tidiga tecken på demens är vanligen glömska och ökade besvär med att hitta utanför sin närmiljö. Saker som man tidigare klarade av blir svåra att planera och utföra. Språket drabbas av att man allt oftare får problem att hitta rätt ord.

Även irritation, nedstämdhet och personlighetsförändringar kan höra till sjukdomsbilden. Symtomen varierar beroende på typ av sjukdom och skada.

## Från mild till svår demenssjukdom

Demenssjukdomen har ofta ett utdraget förlopp över många år. Sjukdomen utvecklas gradvis, nya symtom tillkommer och förmågor går förlorade. Efterhand behöver den sjuke allt mer hjälp och stöd för att klara sin vardag.

Sjukdomsförloppet brukar delas in i tre faser: mild, medelsvår och svår demenssjukdom.



## Tidig diagnos viktig

Tveka inte att kontakta en läkare vid misstanke om demenssjukdom. En utredning bör snarast påbörjas för att i god tid få rätt diagnos, hjälp och behandling. Utredningen omfattar en rad olika tester och undersökningar.

Det finns flera sjukdomstillstånd som kan ge demensliknande symtom och som går att bota. Om en demenssjukdom diagnosticeras kan läkemedel i vissa fall lindra symtomen. Hjälpmedel och en rad andra insatser kan underlätta vardagen.

## Planera för framtiden

Det är också viktigt, både för den som är sjuk och för de anhöriga, att få en förklaring till symtomen. Kunskap om sjukdomen gör det lättare att planera för ett bra och meningsfullt liv. Att dela erfarenheter med personer i liknande situation upplevs ofta som värdefullt.

2025 • Svenskt Demenscentrum ©

---

Fler faktablad på olika språk kan skrivas ut från Svenskt Demenscentrums webbplats:  
[www.demenscentrum.se/Faktablad](http://www.demenscentrum.se/Faktablad)

---



Svenskt Demenscentrum

Svenskt Demenscentrum, Sveavägen 155, 113 46 Stockholm, 08 - 690 58 00, [info@demenscentrum.se](mailto:info@demenscentrum.se)

[www.demenscentrum.se](http://www.demenscentrum.se)